



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20085 Prot

Lezhë, më 21 / 12 /2022

VENDIM

Nr. 136, Datë 20. 12.2022

“Për përdorim fondi të emergjencës, për blerje pako ushqimore për familjet e dëmtuara nga përmytjet e reshjeve të shiut më dt 20.11.2022 në Njësitë Balldre, Blinisht, Dajç të Bashkisë Lezhë”

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të ligjit Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM Nr.329, dt.16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, bazuar në kërkesën e paraqitur nga Drejtoria e Emergjencave Civile, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Keshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi:

1.Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencave në shumën 100.000 lekë per 50 familje të përmytura nga reshjet e datës 20.11.2022, në Njësitë Administrative Balldre, Blinisht dhe Dajç të Bashkisë Lezhë nga fondi 602. Për këtë të kryhen veprimet si më poshtë ;

Pakësohet; Gr 00, Prog 03280, Kap 5, Art 602 në shumën 100.000 lekë për zërin; Ndërhyrje urgjente; Për blerjen e pakove ushqimore .

Shtohet; Gr 00, Prog 03280, Kap 5, Art 602 për zërin ‘Blerje pako ushqimore në shumën 100.000 lekë’

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

NDUE LULI



Prot 20065/
12.12.22
k.B.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE PËRBALLIMIT TË MBROJTJES CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 949/3 Prot.

Lezhë, më 22.12.2022

Lënda: Konfirmim vendimi.

KËSHILLIT TË BASHKISË

KRYETARIT TË BASHKISË

LEZHË

Bazuar në ligjin nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2/b; në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjes vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, 1.1, gërma 'b', neni 54, gërma 'n'; neni 55; në ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", neni 41, si dhe në VKM nr.329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", **konfirmoj** bazueshmërinë ligjore të **Vendimit nr.136**, datë 20.12.2022, "Për përdorim fondi të emërgjencës, për blerje pako ushqimore për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e reshjeve të shiut më dt.20.11.2022, në Njësitë Balldre, Blinisht, Dajç të Bashkisë Lezhë", bashkia Lezhë.

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

